

26. Për 783 milion njerëz që jetojnë poshtë vijës ndërkombëtare të varfërisë me 1.90 dollarë në ditë, më shumë se gjysma e të cilëve janë në shkretëtirën sub-sahariane të Afrikës.

27. Gratë e varfëra dhe të shtypura në Serbi që shpesh kanë mungesë mbështetje dhe mundësi për t'u zhvilluar përmes edukimit dhe punësimit.

28. Ata 844 milion njerëz në mbarë botën që u mungon uji i pijshëm dhe 2.3 bilion njerëz që nuk kanë tualete.

29. Rritjen e mundësive të arsimit për romët në Bullgari. Më shumë se 68% e romëve janë shumë të varfër për shkak të nivelit të ulët të arsimit.

30. Personat e papunë në Ukrainë, që rrisin familjet me të ardhura shumë të ulta ose janë të detyruar të largohen nga vendi në kërkim të punës. Lutuni që ata do të gjejnë shpresë në Jezusin në mes të gjithë situatave të tyre të vështira.

**Dëgjoni programin “Shpresë për ty” në:**

**Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30**

**Radio Emanuel: 95,7 FM:**

të shtunën ora 9:00

**Radio Logos: 94,2 FM**

të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00



Perëndia ka një zemër të dhembshur për të varfërit, të përlulurit, dhe për ata që kanë një frymë të dërrmuar. Thirrjet tona për ndihmë drejtuar Atij nuk injorohen. Me zgjedhjen e Adamit dhe Evës për të mëkatuar erdhën marrëdhëniet e thyera me Perëndinë, korrupsioni bashkë me luftën brenda familjeve dhe shoqërive tona. Vdekja, sëmundjet dhe thyerja erdhi në trupat tanë. Madje edhe toka rënkon nga fatkeqësitë e saj natyrore si thatësira, uria dhe përmbytjet.

Por, Zoti nuk na lë vetëm në varfërinë dhe mjerimin tonë. Zoti ecën me ne përmes kohërave të vështira. Ai na jep forcë në Të për të këmbëngulur. Shkrimi zbulon se Zoti është “një strehë për të varfërin, një kështjellë për të mjerin në fatkeqësinë e tij, një strehë kundër stuhisë, një hije kundër të nxehtit” (Isaia 25:4). Ndërsa dëgjuesit dëgjojnë programet “Shpresë për ty” në mbarë globin, ata po drejtohen drejt Zotit që i shikon dhe i dëgjon dhe vepron në të mirë të tyre.

Zoti siguron për nevojat tona menjëherë kur ne i kërkojmë atij, “Bukën e përditshme na e jep sot” (Mateu 6:11). Por, Zoti shpesh thërret fëmijët e tij të plotësojnë nevojat e atyre rreth e rrotull tyre. Si ndërmjetësues të “TWR Shpresë për ty”, ne bashkohemi me motrat dhe vëllezërit rreth e rrotull botës që kërkojnë përmbushjen e nevojave bazë të jetës. Zoti na thërret të lutemi me besnikëri dhe të veprojmë për të “thyer zinxhirët e ligësisë, të zgjidhim verigat e zgjedhës, t'i lëmë të lirë të shtypurit, të dërmojmë çdo zgjedhë ... të ndajmë bukën tonë me atë që ka uri, të sjellim në shtëpi atë që është i pastrehë – dhe të veshim ata që janë lakuriq.” (Isaia 58:6-8).

Ashtu si lutemi për ata që janë të varfër, le të japim gjithashtu paratë tona, kohën tonë dhe aftësitë për t'i ndihmuar me ushqim, ujë të pastër, higjenë, arsimit, kujdes shëndetsor, elektricitet, punë dhe lajmin e dashurisë së Zotit dhe shpëtimit të tij për ata që janë në nevojë.

Zoti ka një zemër të dhembshur për të varfërit. Lutuni që ata që ndodhen në nevoja të mëdha do t'i kenë sytë e tyre të hapur që të shohin që nevoja më e madhe e të gjithëve është Zoti.

“TWR Shpresë për ty: Të sjellim shpresë në Jezusin tek gratë anë e mbanë botës dhe përtej brezave.”

*Të lutemi që t'i jepet fund varfërisë*



Programi “Shpresë për ty” transmetohet në 73 gjuhë.

Kërkesat mujore të lutjes përdoren në 100 gjuhë.

Dëgjoni kalendarin e lutjes online në: [twr-albania.com](http://twr-albania.com)

1. Ata që dëgjojnë programet “Shpresë për ty” që të kuptojnë se Zoti kujdeset për ta dhe Ai do t’u japë forcën, kurajon dhe vendosmërinë për ecur edhe përmes rrethanave më të vështira të jetës.

2. Organizatat që ndihmojnë dhe qeveritë të mbajnë përgjegjës zyrtarët për përdorimin e duhur të parave, ushqimit dhe furnizimeve që jepen për të ndihmuar njerëzit që vuajnë për shkak të varfërisë ekstreme, refugjatëve dhe fatkeqsive natyrore.

3. Një grup i rrënuar vejushash në Indi të pranojnë shpëtimin dhe të kenë furnizime nga ana materiale. Kohët e fundit ato kanë dëgjuar për ungjillin dhe kanë marrë batanije, çarçafë, peshqirë dhe sari (veshje tradicionale në Indi) nga skuadrat “Shpresë për ty” atje.

4. Pleqtë, sakatët, dhe gratë që drejtojnë familjet në Korenë e Jugut dhe që përballen me nivele të thella varfërie. Ne lutemi për të larguarit nga Korea e Jugut që janë arratisur nga mungesa dhe nga një qeveri autoritare.

5. Krizën ekonomike në Turqi, që ka rezultuar në mungesa ushqimore dhe papunësi. Frika dhe presioni po i shtyjnë shumë njerëz të kërkojnë një jetë të re. Lavdëroni Zotin për ata 10 vetë që kanë pranuar Krishtin përmes programit “Shpresë për ty”.

6. Besimtarët e të gjitha niveleve ekonomike të kenë zemra mirënjohëse ndërsa mbështeten tek Zoti për sigurinë e tyre materiale. Lutemi që ata të ndjekin atë që Zoti kërkon dhe dëshiron për ta që të bëjnë dhe të mos kërkojnë punësim thjesht për para ose për të zgjidhur problemet e tyre.

7. Besimi i të varfërit të forcohet ndërsa ne lutemi: “Dëgjoni, vëllezër të mi shumë të dashur, a nuk i zgjodhi Perëndia të varfërit e botës, që të jenë të pasur në besim dhe trashëgimtarë të mbretërisë që ua premtoi atyre që e duan?” (Jakobi 2:5).

8. Studentët, prindërit e vetëm dhe pleqtë në Francë që kanë vështirësi për të mbijetuar. Shumë punojnë disa punë për shkak të rrogave të ulta dhe shkojnë tek organizatat bamirëse për të siguruar ushqim.

9. Skuadrat “TWR Shpresë për ty” dhe ndërmjetësuesit të sigurojnë aftësi trajnimi, këshillim financiar, seminare për shëndetin, ose ushqim, rroba për ata që janë në nevojë.

10. Gratë në Etiopi që po luftojnë për të mbijetuar dhe kanë nevojë për mënyra të reja për të gjeneruar të ardhura. Disa mbledhin dru nga pylli dhe i shesin për më pak se koston e një vakti. (Psalmi 70:5)

11. Dëgjuarit e programit “Shpresë për ty” në Nepal, që përveç udhëzimeve shpirtërore po marrin edhe aftësi trajnuese për të bërë këpucë e qepur rroba, në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura.

12. Ato mijëra prostituta në Gjermani, shumica prej vendeve më të varfra të Evropës Lindore, që të mund të shpëtojnë nga varfëria e tyre dhe të arrihen përmes serive të radiodramave “Thesare të fshehura”.

13. Gratë e burgosura në Paraguaj që dëgjojnë programin “Shpresë për ty” dhe luten sëbashku. Lavdëroni Zotin për këtë shërbesë dhe kërkojini Atij që ato të gjejnë punë dhe mbështetje nga të krishterët kur të lirohen.

14. Të lutemi që zemrat e besimtarëve të zbuten drejt nevojtarëve. “Kush mbyll veshin ndaj britmës së të varfërit, do të bërtasë edhe ai, por nuk do të ketë përgjigje” (Fjalët e Urta 21:13)

15. Më shumë se 3 milionë venezuelas që janë larguar nga vendi për shkak të dhunës dhe mungesës së ushqimeve dhe ilaçeve. Mbi 1 milion janë shpërngulur në Kolumbinë fqinje. (Psalmi 12:5).

16. Më shumë radio, pajisje mp3, dhe pajisje të tjera audio që të sigurohen për gratë që nuk janë në gjendje t’i blejnë, por janë të etura të dëgjojnë

programet “Shpresë për ty”.

17. Ndërmarrjen e hapave për të eliminuar shkaqet e varfërisë globale, duke përfshirë papunësinë, përjashtimin social dhe prekjen nga fatkeqësitë, sëmundjet apo kërcënime të tjera.

18. Gratë dhe fëmijët që jetojnë në mes të varfërisë ekstreme dhe janë në nevojë për ushqim, ujë të pastër, higijenën e duhur, shtëpi të sigurta, kujdes shëndetsor dhe të ardhura të mjaftueshme.

19. Punëdhënësit në Shqipëri të kenë frikë nga Zoti dhe t’i paguajnë punëmarrësit e tyre çdo muaj. Shumë punëtorë presin për të marrë rrogën dy deri në tre muaj – dhe si përfundim kur e marrin e gjitha shkon për të larë borxhet.

20. Refugjatët e rrënuar që jetojnë në rrugë dhe lypin para. Shumë gra dhe fëmijë janë të detyruar të prostitutojnë ose të martohen me burra shumë më të mëdhenj për para (Psalmi 82:3-4)

21. Kontrollimin e korrupsionit të gjerë që raportohet në Kenia. Pothuajse 50% e popullsisë jeton në mjerim. Lutuni për gratë që të gjejnë punë për të ushqyer familjet e tyre (Psalmi 35:10).

22. Njerëzit në Somali që përballen me varfërinë ekstreme për shkak të qeverisjes së paqëndrueshme, mosmarrveshjeve civile, përmbytjeve dhe thatësisë.

23. Njerëzit e Uruguajit që kanë paga të ulta, shërbime të shtrenjta, një popullsi të pastrehë dhe një popullatë me emigrim në rritje.

24. Të gjithë ata në Ruanda që janë në nevojë të mund të përfitojnë nga përpjekjet e qeverisë për të reduktuar varfërinë. Lavdëroni Zotin për hapat që po merren atje.

25. Të gjithë njerëzit në Poloni që janë të rrënuar për shkak të situatave individuale të jetës dhe për ata që mezi po ia dalin të mbijetojnë.